

**KORNIZA E KURRIKULIT
TË RI
TË KOSOVËS**

– Arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë –

Libri i bardhë për diskutim – Shtator 2001

Prishtinë/Pristina, 2001

Lëshimi i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës në qarkullim për diskutim publik në Web Site Botëror

Pas dhjetë vjetësh të sistemit paralel në arsim dhe luftës së vitit 1999, shoqëria Kosovare dhe sistemi i arsimit të Kosovës ballafaqohen me mundësi dhe sfida të reja. Siq është e njohur nga një pjesë e madhe e popullatës, reforma arsimore është një prej proceseve më të rëndësishme që ka për qëllim të përtrijë lidhjen e shoqërisë Kosovare me zhvillimet ndërkombëtare dhe të ofroj parakushtet për progresin ekonomik dhe shoqëror.

Me qëllim që të forcohet një reformë arsimore e ngjeshur, Departamenti i Arsimit dhe Shkencës në kuadër të UNMIK-ut, vitin e kaluar inicoi të ashtuquajturën “strategji të agjencioneve prirëse”, ku organizatat e ndryshme u ftuan të përkrahin dhe të mirren me lëmitë specifike të procesit të ndryshimeve në arsim.

Në fund të vitit 2000, UNICEF-i, zyra në Kosovë, u ftua të veproj si agjenci prirëse për zhvillimin e kurrikulit. UNICEF-i u zotua që t’ a përkrah procesin e ndryshimit të kurrikulit, duke pasur parasysh dy aktivitete kryesore:

Zhvillimin e Kornizës së Kurrikulit të Ri, përcaktimin e orientimeve kryesore për një reformë të qëndrueshme të kurrikulit dhe për ngritjen e cilësisë dhe barazisë në sistemin e arsimit të bazuar në të nxënit progresiv, synimet dhe objektivat, përmbajtjet, metodologjitë e mësimdhënies dhe të nxënit, procedurave të çmuarjes dhe vlerësimit (nëntor 2000- vjeshtë 2001)

Zhvillimin e udhëzimeve të reja për arsimin parashkollor dhe kurrikuleve të reja të lëndëve për shkollën fillore në të gjitha lëmitë e kurrikulit (vjeshtë 2001- 2002).

Në bazë të parimeve të UNICEF-it, zyra në Kosovë, procesi i zhvillimit të kurrikulit është disajnuar për popullin e Kosovës. Kështu që në fazën e parë, Grupi Bërthamë i Kurrikulit që u themelua brenda Departamentit të Arsimit dhe Shkencës, si detyrë primare kishte që të zhvillojë Kornizën e Kurrikulit të Ri të Kosovës.

UNICEF-i, zyra në Kosovë, e përkrahu procesin në aspektin financiar dhe profesional.

Nën kujdesin e IBE UNESCO (zyra ndërkombëtare për arsim) për anëtarët e Grupit Bërthamë, në dhejtor të vitit 2000 organizoi një kurs intensiv në zhvillimin e kurrikulit në përgjithësi.

Me qëllim që të ndihmojë Grupin Bërthamë në finalizimin e Kornizës së Kurrikulit, UNICEF-i zyra në Kosovë, siguroi këshillëtar ndërkombëtar për kurrikule që filloi punën në mars të vitit 2001. UNICEF-i, zyra në Kosovë, poashtu i mundësoi DASH-it organizimin e konsultimeve publike - gjithëpërfshirëse në faza të ndryshme të zhvillimit të Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës.

Në shtator të vitit 2001, u lëshua në qarkullim për diskutim publik Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës si libër i bardhë për diskutim në tri gjuhë: Shqip, Serbisht dhe Anglisht. Në afatin kohor prej dy muajsh, mësuesit, nxënësit, prindërit dhe të interesuarit e tjerë për arsim u ftuan që të japin informatat kthyesë, me qëllim të plotësimit të dokumentit para se të finalizohet.

Shpresojmë se procesi i zhvillimit të kurrikulit në Kosovë, prezenton një përvojë të vlefshme jo vetëm për popullin e Kosovës, por edhe për tërë regjionin e Ballkanit. Në

aspekte të ndryshme, Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës është dokument unik, i pari i këtij lloji në regjionin e Ballkanit, që synon përcaktimin e parametrave kryesorë për një proces të qëndrueshëm dhe dinamik të reformës së kurrikulit. Si dokument kryesor i politikës së kurrikulit, do të shërbejë si bazë për zhvillimin e kurrikulit të lëndëve, orientimet e reja për çmuarje dhe vlerësim dhe për përtirjen e mësimdhënies dhe të nxënit. Do të ndikojë në organizimin e shkollës dhe në raportin më të mirë të shkollës/shoqërisë.

Tani kemi kënaqësinë të lëshojmë në qarkullim Kornizën e Kurrikulit të Ri të Kosovës për diskutim publik poashtu në web site. Të gjithë ata të cilët dëshirojnë të japin kontributin e tyre në këtë faze të konsultimeve, janë të ftuar të na dërgojnë informatat e tyre kthyesë, duke pasur parasysh çështjet e mëposhtme:

- Çka është e vlefshme në dokument?
- Çka mungon në dokument?
- Çfarë duhet ndryshuar (në strukture, gjuhë, përmbajtje)?
- Çfarë duhet sqaruar më me kujdes?

Informatat e juaja kthyesë (në gjuhën shqipe, serbe ose angleze) mund t'i dërgoni në këto adresa: Znj.Dakmara Georgescu, këshillëtare ndërkombëtare për kurrikule (dakmara_georgescu@yahoo.com); Znj.Luljeta Belegu-Demjaha, zyrtare e përkohshme e kurrikulit (lulebd@hotmail.com) ; Z.Ramush Lekaj, anëtarë i Grupit Bërthamë (ramushl@hotmail.com).

Grupi Bërthamë i Kurrikulit, Departamenti i Arsimit dhe i Shkencës

Lindita Ibishi Boshtrakaj – zyrtare për kurrikulet
Luljeta Belegu Demjaha – zyrtare e përkohshme e kurrikulit

Anëtarët:

Anton Gojani
Arbër Salihu
Azem Azemi
Feime Llapashtica
Hajrije Devetaku
Mehmet Guri
Nehar Shishko
Ramush Lekaj
Shqipe Gashi

Konsultante e kurrikulit: Dakmara Georgescu, UNICEF-zyra në Kosovë/ UNMIK-DASH

Anëtarët e Grupit Bërthamë të Kurrikulit i janë mirënjohës UNICEF-it, zyra në Kosovë, agjenci prirëse për zhvillimin e kurrikulit, për përkrahjen e tërësishme të tij.

Anëtarët e Grupit Bërthamë të Kurrikulit janë po ashtu mirënjohës për sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna gjatë procesit të përpilimit të tekstit për draftin e Kornizës së Kurrikulit të ri të Kosovës nga individët, institucionet dhe organizatat shënuar në Shtojcën 1.

Parathënie

Që nga fillimi i veprimtarisë në Kosovë, Departamenti i Arsimit dhe Shkencës reformën e arsimit e ka mbështetur mbi dy shtylla: (a) përfshirja e ekspertëve dhe specialistëve vendorë në punën themelore -bërthamë për disenjimin e strukturave të reja; dhe (b) caktimi i "agjencive prirëse", të cilat ndihmojnë qeverisjen e Departamentit dhe përpiqen të implementojnë e të ndjekin punën e tij, duke i bërë programet e tij të qëndrueshme dhe të realizueshme. Ata së bashku me grupin tonë të kurrikulit, të prirë nga UNICEF-i dhe me një ekip të konsiderueshëm vendor, kanë përbërë një kombinim ideal.

Kjo që prezantohet tash, është hapi i parë gjithëpërfshirës, por jo edhe plani kryesor përfundimtar. Kurrikuli nuk përlij hapa të nxituar për sa i përket një ose më shumë programeve, por është një proces në vetvete. Kurrikuli i mirë është një 'sistem', i varur shumë nga mjedisi. Ai mund të përbëhet prej elementeve krejtësisht të ndryshme, siç janë: trajnimi i mësimitdhënësve, standardet e cilësisë, parashikimet politike dhe traditat. Për Kosovën përputhshmëria me reformat në tërë Evropën, dhe kryesisht me reformat në Ballkan, është më e rëndësishmja. Në të ardhmen nuk do të ketë ishuj të izoluar të arsimit pranë njëri-tjetrit; përkundrazi do të ekzistojnë rrjete të arsimit, të cilat do ta mbajnë baraspeshën ndërmjet standardeve përgjithësisht të pranuarra dhe specifikeve vendore.

Që nga fillimi roli i ndërkombëtarve dhe i UNICEF-it është përqëndruar në këtë aspekt të 'evropianizimit'. Kjo nënkupton shumë ndryshime në metodologji, didaktikë dhe në implementimin praktik të kurrikulit. Po ashtu nënkupton një ndërgjegjësim për përmbajtjet e reja, për përqëndrimet dhe specializimet e reja, për praktika model në mësimitdhënie, për qasje të përqëndruara tek nxënësi, si dhe për realizimin e kërkesës për një shoqëri civile në klasa dhe shkolla.

A është i tillë kurrikuli demokratik? Jo, nuk është. Por kurrikuli në shoqërinë demokratike dallon dukshëm, dhe është më i mirë se alternativat e tij në strukturat (shoqëritë) diktatoriale apo autoritare. A është i mundshëm dhe i dëshirueshëm një kurrikul i njësuar? Po, por vetëm brenda kufizimeve të vëna nëpërmjet autonomisë së arsimit në universin mikrosocial të ndërveprimit mësimitdhënës-nxënës, dhe mbi dialektikën ndërmjet opcioneve thelbësore dhe të shumëfishta që burojnë prej të drejtave dhe prioriteteve individuale dhe të përbashkëta. Homogjeniteti nuk është më i vlefshëm se çdo gjë. Një shoqëri si kjo në Kosovë, nuk mund të përballojë një tablo të pastrukturuar të kurrikulit me përzjerje primitive të mbetjeve tradicionale, individuale dhe kolektive.

Kurrikuli në esencë edhe me specifikat e tij nuk zëvendëson punën e silabit (programit), i cili duhet të jetë i hapur ndaj kërkesave konkrete që burojnë nga realiteti. Para së gjithash, personalitetet e guximshme, të hapura dhe humane duhet të jenë në ballë të zhvillimit të

silabeve. Ndoshta ato do të mund të disenjoheshin individualisht për një shkollë apo klasë, duke mbajtur parasysh kushtet dhe rrethanat e caktuara.

Siç thotë Arend Hannah: “Baza logjike/racionale e politikës është liria”. Për kurrikulin në Kosovën e re, kjo thënie mund të modifikohet në: “Baza logjike e kurrikulit tonë është arsimimi qytetar në një shoqëri qytetare”.

Michael Daxner
Bashkëkryesues ndërkombëtar,
Departamenti i Arsimit dhe Shkencës/UNMIK

Parathënie

Jetojmë në një kohë të ndryshimeve rapide, por edhe të mundësive të mëdha. Kjo supozon që zhvillimet në fushën e arsimit duhet të përqëndrohen jo vetëm në rimëkëmbjen, por edhe në rivitalizimin e tërë sistemit arsimor, në mënyrë që të krijohen kushtet për zhvillimin e vlerave të reja në rininë kosovare. Nisur nga kjo, orientimet kryesore të reformës së arsimit kanë të bëjnë me aftësimin e gjeneratës së re që të ballafaqohet me sfidat që po vijnë dhe t'u përshtatet rrethanave të reja. Jemi të vetdijsëm se angazhimet e bëra dy vitet e fundit paralajmërojnë rezultate të mira, por ende mbetet shumë për t'u bërë.

Ne këte kontekst, pune e madhe është bërë edhe në fushën e kurrikulit. Duke pasqyruar se kurrikuli është bosht i zhvillimeve në fushën e edukimit, ai duhet të jetë rezultat i një procesi të gjerë të konsultimeve dhe duhet të reflektojë besimin në gjeneratën e re, si fuqi udhëheqëse e vendit. Kërkesat që shtrohen në këtë kornizë supozojnë një qasje më të guximshme ndaj ndryshimeve në fushën e edukimit dhe besim më të madh në gjeneratat e reja dhe në vet mësuesit dhe menaxhuesit e shkollave .

Ky dokument është një artikulum i objektivave dhe i një metodologjie të punës, por do të bëhet realitet vetëm kur autoritetet e ndryshme në shoqërinë kosovare ta shprehin përkrahjen e tyre ,duke e pranuar atë si një projekt të përbashët .

Është momenti i fundit që të fillojmë të kuptojmë më seriozisht rolin tonë në vendosjen e një baze të shëndoshë për gjeneratat që po vijnë ,një baze të shëndoshë drejt një shoqërie demokratike dhe të përcaktuar për nxënie.

Shfrytëzojmë rastin të falënderojmë të gjithë ata që kanë ndihmuar dhe përkrahur procesin e zhvillimit të kurrikulit deri në këtë fazë dhe t'i urojmë të gjithë ata që me aq përkushtim punuan në vendosjen e njërës prej mekanizmave më të rëndësishëm në fushën e arsimit.

Naim Rrustemi

Bashkëkryesues i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës

STRUKTURA E PROPOZUAR E KORNIZËS SË KURRIKULIT TË RI TË KOSOVËS

ARSIMIMI, KURRIKULI DHE SFIDAT PËR NJË BOTË NË NDRYSHIM E SIPËR

KAPITULLI I - KURRIKULI I RI I KOSOVËS

- Nevojat dhe kushtet për një kurrikul të ri në Kosovë
- Karakteristikat e kurrikulit të ri
 - Korniza e Kurrikulit të ri të Kosovës: përmbajtja dhe funksionet
 - Parimet për zhvillimin e kurrikulit të ri
 - Roli i Kurrikulit bërthamë në orientimin e veprimtarive shkollore
- Synimet e përgjithshme të arsimit në Kosovë

KAPITULLI II – SISTEMI ARSIMOR: OBJEKTIVAT DHE REZULTATET

- Struktura e re e sistemit të arsimit: pasojat për zhvillimin e kurrikulit
- Objektivat dhe rezultatet e niveleve të ndryshme formale të shkollimit (sipas strukturës së re 5+4+3) dhe shkallët kryesore të kurrikulit

KAPITULLI III – OBJEKTIVAT DHE ÇËSHTJET NDËRRKURRIKULARE

- Objektivat ndërkurrikularë
- Çështjet ndërkurrikulare dhe dimensionet e reja të arsimit

KAPITULLI IV – LËMENJTË E KURRIKULIT

- Kurrikuli bërthamë dhe pjesa sipas zgjedhjes e kurrikulit (kurrikuli i përcaktuar nga shkolla)
- Lëmenjtë e kurrikulit dhe përshkrimi i lëndëve mësimore: objektivat dhe rëndësia për zhvillimin e nxënësit
- Lëmenjtë e kurrikulit dhe lëndët mësimore: plani mësimor, menaxhimi i planit mësimor nga ana e shkollës

KAPITULLI V – DISPOZITAT E VEÇANTA TË KURRIKULIT

- Zgjidhjet fleksibile dhe përfshirëse
- Dispozitat e veçanta të kurrikulit

KAPITULLI VI – PARIMET E IMPLEMENTIMIT PEDAGOGJIK TË KORNIZËS SË KURRIKULIT TË RI TË KOSOVËS

- Organizimi i shkollës – si duhet të funksionojë shkolla në mënyrë që t’i përmbushë kërkesat e kurrikulit të ri
- Mësimdhënia dhe nxënia: udhëzime metodologjike
- Çmuarja dhe vlerësimi
- Veprimtaritë e nxënësve

KAPITULLI VII – UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E KURRIKULIT TË LËNDËVE MËSIMORE

- Zhvillimi i kurrikuleve të lëndëve mësimore dhe i silabeve sipas Kornizës së Kurrikulit të ri të Kosovës
- Struktura e kurrikuleve të lëndëve mësimore

KAPITULLI VIII – UDHËZIME PËR ZHVILLIMIN E TEKSTEVE TË REJA DHE MJETEVE TË TJERA MËSIMORE

- Përdorimi i teksteve dhe mjeteve mësimore në procesin e mësimdhënies dhe nxënies
- Rrjedhjet e Kurrikulit të ri për disenjimin e teksteve dhe mjeteve të tjera mësimore
- Kriteret pedagogjike për zhvillimin, zgjedhjen dhe përdorimin e materialeve mësimore

KAPITULLI IX – UDHËZIME PËR IMPLEMENTIMIN DHE ORARI I IMPLEMENTIMIT. UDHËZIME PËR PERIUdhËN KALIMTARE

- Skenaret e implementimit
- Udhëzime për periudhën kalimtare

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

ARSIMIMI, KURRIKULI DHE SFIDAT PËR NJË BOTË NË NDRYSHIM E SIPËR

Shoqëritë bashkëkohore arsimimin e konsiderojnë ndër pasuritë më të rëndësishme të njerëzimit dhe përpiqen të gjurmojnë potencialin e tij të plotë, në mënyrë që t'u ndihmojnë njerëzve të ballafaqohen me sfidat e botës së sotme. Sipas Raportit të Delorit (Jacques Delors) për UNESCO-n "*Education: the treasure within*" (UNESCO, 1996), e në pajtim me prirjet e sotme të botës, katër shtyllat e arsimimit janë: të mësosh për të ditur, të mësosh për të vepruar, të mësosh për të qenë dhe të mësosh për të jetuar së bashku me të tjerët. Përveç kësaj, kohët e fundit, UNICEF-i e nxjerr në pah edhe shtyllën e pestë: të mësuarit për ta transformuar vetëveten dhe shoqërinë. Kjo do të thotë se nuk duhet vetëm të pajtohemi me realitetin dhe t'i përshtatemi atij, por duhet përpjekur ta transformojmë atë, duke qenë të autorizuar nëpërmjet arsimimit që ta bëjmë këtë.

Në përputhje me nevojën për të siguruar iniciativa të përshtatshme në fushë të arsimit ndaj sfidave të botës së sotme, reformat e kurrikulit dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kurrikulit janë ndër preokupimet më të mëdha të autoriteteve të arsimit dhe të shoqërive civile në shumë vende.

Kurrikuli është ndër mjetet më të rëndësishme për sigurimin e një arsimimi cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë së caktuar, pavarësisht nga seksi, përkatësia etnike, ngjyra e lëkurës, pozita shoqërore apo nga dallime të tjera.

Kurrikuli, si **mishërim i një artikulimi koherent të synimeve dhe objektivave, përmbajtjeve, metodave të mësimdhënies e nxënies dhe si bazë për çmuarje e vlerësim**, është jo vetëm pasqyrim i një shoqërie dhe kulture të caktuar, por edhe projektim i ardhshëm se si do të duket kjo shoqëri. Ai gjithashtu parashikon se si do të duhej të pajiseshin nxënësit që të jenë në gjendje të ballafaqohen me sukses me sfidat e ndryshme të realitetit të përditshëm.

Dispozitat e kurrikulit trajtojnë çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me faktin se çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit, cilat vlera duhen kultivuar, si të aftësohen nxënësit që të jenë në gjendje të jetojnë së bashku me të tjerët dhe si të mbështetet zhvillimi i plotë i potencialit të tyre, me qëllim që ata të mund të kontribuojnë në mënyrë aktive për mirëqenien e shoqërisë dhe mirëqenien e tyre personale. Nisur nga kjo, zhvillimi i kurrikulit është preokupim kryesor i çdo shoqërie, prandaj duhet të jetë rezultat i një procesi këshillimesh të gjera, duke inkuadruar në një bashkëpunim sa më të plotë të gjithë faktorët e interesuar.

Nevoja e përhershme për ridisnjimin e shkollimit dhe për ripërkufizimin e qëllimeve dhe objektivave të tij, lidhet me ndryshimet që shfaqen në shoqëri, ekonomi, politikë, shkencë e teknologji. Pasojat e këtyre ndryshimeve janë:

- nevojat e reja të shoqërisë;
- ndryshimet në tregun e punës;

- risitë teknologjike;
- ndryshimet e aspiratave të njerëzve sa i përket diturisë dhe shkathtësive me të cilat duhet të pajisen nxënësit në shkollë;
- ndryshimet e pikëpamjeve të njerëzve rreth çështjes se cilat janë parakushtet e domosdoshme për strategji të efektshme të mësimdhënies e të nxënies;
- ndryshimet në kontekstin shoqëror të arsimit.

Duke marrë parasysh këto ndryshime, në botën e sotme, funksionet e shkollës duhet të rishqyrtohen. Shkolla duhet t'u sigurojë nxënësve mundësi që të pajisen me dituri sistematike dhe operative, si dhe me shkathtësitë elementare, të cilat t'u mundësojnë t'i shfrytëzojnë dituritë e tyre në situata të ndryshme me rastin e zgjidhjes së problemeve në mënyrë krijuese; të cilat t'u mundësojnë të dëshmojnë gjithnjë aftësitë e tyre për nxënie të pavarur dhe të zhvillojnë përgjegjësinë për veten e tyre, për të tjerët, për shoqërinë dhe për mjedisin.

Vendi dhe roli i arsimit, i mësimdhënies dhe i nxënies, ripërkufizohen në mënyrë të vazhdueshme në përpjekjet që arsimimi formal t'u ndihmojë të rinjve t'i përmbushin nevojat dhe aspiratat e tyre personale, por njëkohësisht edhe të kontribuojnë me kompetencë dhe me përgjegjësi për mirëqenien e shoqërisë në tërësi.

Më shumë se kurrë më parë, shoqëria pret nga shkollat që t'i aftësojnë fëmijët e të rinjtë për një jetë kuptimplotë e produktive në një shoqëri komplekse, e cila ndryshon vazhdimisht. Përmbajtjet ekzistuese të kurrikuleve dhe metodat pedagogjike po diskutohen gjithnjë e më shumë nga perspektiva e nevojës për **arsimim gjatë tërë jetës** dhe nga perspektiva e nevojës që arsimimi formal të kontribuojë në mënyrë më të efektshme në përgatitjen e brezit të ri për pjesëmarrje të sukseshme në jetën aktive të shoqërisë.

Në trendin aktual të zhvillimit të botës së sotme, të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme jetësore nuk mund të ofrohen vetëm nëpërmjet shkollimit. Shkollat mund të japin një bazë të arsimit dhe mund ta përgatisin njeriun për një proces të nxënies që do të zgjasë gjatë tërë jetës.

Shkolla nuk do të duhej të ishte vend ku fëmijët e të rinjtë dërrmohen nga fakte e informacione që nuk u hyjnë në punë, por më shumë një vendtakim për zhvillimin e tyre vetjak si anëtarë të një shoqërie moderne demokratike.

Shkolla do të duhej të ishte vend ku nxënësit u nënshtrohen në mënyrë sistematike përvojave kuptimplota të nxënies. **Këto përvoja të nxënies nuk do të duhej të përqendroheshin vetëm në informim, por do të duhej të siguronin një balancim të arsyeshëm e të domosdoshëm midis përvetësimit të diturive dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave e qëndrimeve.** Kureshtja e natyrshme e nxënësve dhe gatishmëria për të nxënë, duhet të kultivohen e të stimulohen vazhdimisht. Dispozitat e kurrikulit, por edhe vetë funksionimi i shkollës dhe i veprimtarive të saj, do të duhej të kontribuonin sa më mirë që të jetë e mundur për kultivimin e arsimit si një vlerë e rëndësishme njerëzore, si nga aspekti i zhvillimit individual, ashtu edhe nga aspekti i zhvillimit shoqëror.